

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Sherr për një vajzë! 22-vjeçari shqiptar plagos rëndë me thikë marokenin: Do ju vras
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/sherr-per-nje-vajze-22-vjecari-shqiptar-plagos-rende-me-thike-marokenin-do--i584234
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	redirected

KOHA


KAPUR NGA NE	6 shtator 2026, 08:11:04 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	6 shtator 2026, 09:25:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	9dbb5c43815735f618f3d0a6f09365d8a544b99811104b7e8754fd48dc410f99
TEKSTI	446a869571cfc583a5f17441af78fe5e41cc4d88e8796062955af4e422eda952
PAMJA	b7f414c392be5dfe3bb6e01567cc65f0d0cc480e84d052d0d54152a52d803ef3

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c054e07f0bfbb75cc049fe1ca30adcd3d4fd8bc131f523a9405b1eb46199d13a
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	590baac6c4f2849cba88a9c97beece944a2facab4f12f8937e153132e53136c9
ANKORUAR	Polygon PoS · bllok 47086362
TRANSAKSIONI	0x311244189763d8704b23b9152a8422dd79e30a90c1264d1757967b7d25d9e1d2
IPFS	Qmekd6BFYFEWABFFs3Smecj47nXVJZ4Wj4QrYBZunJ441f



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/c054e07f0bfbb75cc049fe1ca30adcd3d4fd8bc131f523a9405b1eb46199d13a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)

English

ie - GJKKO nuk mund te jete zgjatim i 313-es! Liri per çirimitaret! - pas Prishtines e Dyseldorht, mesazhi per ish-kreret e UÇK-se te henen ne Times Squaret qinjet rretejne ate fundit

Sherr për një vajzë! 22-vjeçari shqiptar plagos rëndë me thikë marokenin: Do ju vras

TemA

6 Shtator 2026, 11:25Bota TEMA



Një konflikt i nisur dyshohet për motive xhelozie përfundoi në një përleshje të përgjakshme pranë stacionit të trenit në Treviglio të Italisë. Një 35-vjeçar me origjinë marokene mbeti i plagosur rëndë pasi u godit me thikë nga një 22-vjeçar shqiptar, i cili është arrestuar dhe ndodhet në burg, nën akuzën për tentativë vrasjeje.

Ngjarja ndodhi të enjten mbrëma, rreth orës 22:00. Dy personat zbritën nga i njëjti tren në stacionin e Treviglios, ku 35-vjeçarin e prisnin edhe dy persona të tjerë, miq të tij. Sipas dëshmitarëve të mbledhura nga hetuesit, mes tyre nisi një debat që shumë shpejt u përshkallëzua në përplasje fizike.

Një dëshmitar, pronar i një lokali pranë stacionit, tha se kishte parë dy personat duke debatuar që në momentin kur zbritën nga treni. Sipas tij, 22-vjeçari shqiptar bërtiste dhe kërcënonte rivalët. *"Do ju vras"*, thoshte i riu.

Kamerat e sigurisë kanë dokumentuar një pjesë të konfliktit në zonën e stacionit. Sipas rindërtimit paraprak të ngjarjes nga karabinierët, 35-vjeçari dyshohet se kishte kërcënuar shqiptarin në nënkallim, duke përdorur një thikë të madhe kuzhine.

Konflikti nuk përfundoi aty. Pak më vonë, në një parkim në bulevardin Vittorio Veneto, pranë xhamisë, 22-vjeçari, i armatosur me dy thika, dyshohet se ndoqi 35-vjeçarin dhe e goditi në krah dhe në pjesën e mesit të shpinës.

Dëshmitarët që ndodheshin në zonë, mes tyre persona që po shkonin për t'u falur në xhami, panë momentin e sulmit. Një grua që ishte dëshmitare e ngjarjes telefonoi ambulancën.

35-vjeçari u transportua me urgjencë në spitalin e Treviglios në gjendje të rëndë. Gjatë ditës së djeshme gjendja e tij u stabilizua, por ai vijon të qëndrojë i shtruar nën kujdesin e mjekëve dhe me prognozë të rezervuar.

Në vendngjarje mbeti një sasi e madhe gjaku, ndërsa autoritetet sekuestruan një thikë me tehtë palosshëm, e cila dyshohet se është përdorur në sulm.

22-vjeçari shqiptar u arrestua që të enjten në mbrëmje nga karabinierët e Treviglios. Hetuesit po përdorin pamjet e kamerave të sigurisë dhe dëshmitë e personave që ndodheshin në zonë për të rindërtuar të gjithë dinamikën e konfliktit.

I riu është marrë në pyetje në burg nga prokurorja Giulia Angeleri. Ai ka pranuar se e ka goditur me thikë 35-vjeçarin, por ka tentuar të minimizojë përgjegjësinë e tij, duke pretenduar se ka reaguar për t'u mbrojtur nga sulmi.

Sipas hetimeve, në qendër të konfliktit dyshohet se qëndron një lidhje sentimentale e 35-vjeçarit. Të hënën, 22-vjeçari do të dalë para gjyqtarit për hetimet paraprake, ku do të zhvillohet seanca për vleftësimin e arrestit.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Eric Trump prezanton pasaportën e re amerikane me portretin e të atit, shpërthejnë kritikën online](#)

08:34 Bota / 4 komente

[Dënohet me varje prezantuesja e TV në Egjipt, akuzohet si pjesë e grupit kriminal të trafikut të drogës](#)

08:25 Bota / 2 komente

SHBA dhe Irani shkëmbejnë sulme hakmarrëse ndaj anijeve, rriten tensionet në Ngushticën e Hormuzit

08:14 Bota

Putin pret të dërguarit e Trump, Uashingtoni: U diskutuan plane thelbësore për fundin e luftës në Ukrainë

08:03 Bota / 5 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.